



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA DIBËR**  
**SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE**

Nr. \_\_\_\_prot.

Peshkopi, më: \_\_.12.2020

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Për: **O.E. ALKO-IMPEX General Construcion**, me Nipt: **K91326028I**, me adrese:  
Tirane Tirane TIRANE Rruga Reshit Petrela,Kompleksi Usluga,kati i 8,prane stacionit te trenit.

\* \* \*

Procedura e prokurimit: Kerkese per propozim

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-73426-09-29-2020.

Përshkrim i shkurtër i kontratës “**Mirembajtja dimerore e rrugeve dhe mirembajtjen e rrugeve te zakonshme**”, **Bashkia Diber 2020** me fond limit **7 451 800 (Shtate million e katerqind e pesedhete nje mije e teteqind) leke pa TVSH**, lloji i procedures eshte Marrveshje Kuader me te gjitha kushtet e percaktuara, me nje Operator Ekonomik, me afat 12 muaj nga data e nenshkrimit te marreveshjes kuader.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet):

Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 42 datë 13 Korrik 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

- “**ALKO-IMPEX General Construcion** “ **sh.p.k**, me Nr Nipti **K91326028I**, me vlere **7.329.000 (Shtate milion e treqind e njezete e nente mije) leke pa tvsh**.
- “**SHEHU**” **sh.p.k**, me Nr. Nipti: J66702707S, me vlere: **6.660.000 (Gjashte milion e gjashteqind e gjashtedhete mije) leke pa tvsh**.
- “**XHANI**” **sh.p.k**, me Nr. Nipti: J87311735O, me vlere: **0 (zero) leke pa tvsh**

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- **“SHEHU” sh.p.k.**, me Nr. Nipti: J66702707S skualifikohet për arsyet si me poshte:

Autoriteti kontraktor Bashkia Diber ka kerkuar si kriter ne dst ne piken 2.3.10 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencat e nevojshme (lëshuar nga QKL) për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçencat:

-Liçencë për stacion transferim e mbetjeve jo te rrezikshme tipi C Kodi III.1.A (lëshuar nga QKL).

Opertori ekonomik Shehu shpk ka ngarkuar ne sistemin e prokurimeve publike nje licence me kategori per sherbime ekspertize per transportim te mbetjeve inerte, me kodin III.2.B. Ku ne te cilen perfshihet vetem transportim te mbetjeve inerte, dhe ne piken e dst eshte kerkuar licence për stacion transferim e mbetjeve jo te rrezikshme, domethene qe ne akt miratimin me nr. 8236 date 26.09.2019 qe eshte ngarkuar nga opertori shehu shpk eshte e cituar: ne piken 4 ,kushtet e licences qe te thote, ku zoteruesi i mbetjeve inerte eshte i detyruar ti dorezoje keto mbetje tek opertoret te cilet jane te pajisur me leje mjedisore (III.I), qe ne kete rast opertori ekonomik nuk ka paraqitur licence te tipit C me kodin III.1.A.per stacion transferim e mbetjeve jo te rrezikshme ,ku opertori ne fjale nuk plotesoni kushtet e AK per proceduren ne fjale te vendosura ne dst dhe per rrjedhoje jeni i skualifikuar nga procedura e prokurimit.

Opertori ekonomik SHEHU shpk ka paraqitur kontrate pune per z.Armand Lika dhe deshmi kualifikimi, por gjate verifikimit ne SPE konstatojme qe opertori ekonomik e ka paraqitur me 20 dite pune ne listepagesen e muajit gusht 2020 personin ne fjale, kjo bazuar dhe ne kontraten e punes qe eshte nenshkruar nga dy palet ku keni pranuar qe z.Armand Lika do te kryeje 40 ore pune ne jave, gje e cila eshte ne kundershtrim me *“Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës“*, per rrjedhoje jeni i skualifikuar nga procedura e prokurimit.

- **"XHANI" sh.p.k.**, me Nr. Nipti: J87311735O skualifikohet për arsyet si me poshte:

Opertori XHANI shpk, nuk ka ngarkuar ne sistemin e prokurimeve publike asnje lloje dokumentacioni per permbushjen e kriterëve ne dst per proceduren ne fjale, por eshte ngarkuar nga ana e tij vetem ekstrakti tregtar, gje e cila opertori ekonomik nuk ploteson anje nga kushtet e vendosura nga AK Bashkia Diber, per proceduren objekt prokurimi

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ju informojmë se eshte identifikuar si operatori ekonomik i suksesshëm:

**OE “ALKO-IMPEX General Construcion “ sh.p.k.**, me Nr Nipti **K91326028I** me vlere 7.329.000 (*Shtate milion e treqind e njezete e nente mije*) **leke pa tvsh.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *Autoriteti Kontraktor Bashkia Diber* brenda 5(pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 29.10.2020

Ankesa: Po

Ankese nr.3898 prot. Date 03.11.2020

Vendimi i ksha nr.1 date 13.11.2020

Vendimi i KPP 560/2020

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Dionis IMERAJ**